



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1884/prot.

Pogradec, më 30.05.2025

VENDIM
Nr. 49, DATË 29 / 05 / 2025

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR SHESH PËR DEPOZITIMIN E PËRKOHSHËM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKA TRANSITI), TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2.

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave, Nr.559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien me qira, per shesh për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti), për pasurinë e ndodhur në fshatin Blacë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Pasuria	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1208	34/1	Blacë, Çërravë	40000	Shesh për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti)

2. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhës te percaktuar ne projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.



3. Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Pikes 5, shkronja "dh", Kreu I, Pikes 6, shkronja "b", germa "i", Kreu II, të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.
4. Tarifat për dhënie me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "12", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie ne Shfrytëzim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
5. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 21 **vota**

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 3

5.Zbardhur më date 30.05.2025